



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 04/143 Nr. ifaq/Br.str./No.pg 08

Data/Datum/Date 29.05.2026

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17, nenit 34 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, nenit 3 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 178/21 të datës 29.03.2021, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 13, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.19 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.05.2026 miraton këtë:

V E N D I M

Për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e këshillave lokale

1. Me këtë vendim emërohet komisioni për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e këshillave lokale në fshatara, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e komunës së Rahovecit.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve, ku 4 (katër) anëtarë janë nga Kuvendi i Komunës, 1 (një) anëtar është nga ekzekutivi i komunës, 1 (një) anëtar nga shoqëria civile dhe 1 (një) anëtar përfaqësues fshati, vendbanimi apo lagjja urbane, si në vijim:
 - 2.1. **Berat Duraku**, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
 - 2.2. **Lirigzon Kastrati**, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
 - 2.3. **Jusuf Dermal**, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
 - 2.4. **Melinda Iska**, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
 - 2.5. **Nora Boshnjaku**, anëtar nga ekzekutivi i Komunës;
 - 2.6. **Adelina Paqarizi**, anëtar nga shoqëria civile;
 - 2.7. **Përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane.**
3. Kryesuesi i komisionit zgjedhet me konsensus të brendshëm të anëtarëve të komisionit.
4. Komisioni është përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së zgjedhjeve për anëtar dhe kryetar të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në Komunën e Rahovecit.
5. Komisioni ka për detyrë që në bashkëpunim dhe përmes Zyrës për Informim, të informoj qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së takimit me qytetarë për zgjedhjen e këshillave lokale përmes: shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe hapësirat e frenkuentura; mediave lokale; ueb-faqes zyrtare të Komunës dhe platformave tjera të komunikimit.
6. Komisioni ka për detyrë që të mbajë procesverbal për çdo takim me qytetarë dhe i njëjti duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e mbajtjes së takimit, numrin dhe listën e pjesëmarrësve dhe i njëjti të nënshkruhet nga kryesuesi i takimit, anëtarët e komisionit dhe procesmbajtësi konform nenit 5 paragrafi 9 dhe 10 i Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 178/21 të datës: 29.03.2021.

7. Obligohet komisioni që punët t'i kryej duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane si dhe Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Rahovecit 01 Nr. 178/21 të datës 29.03.2021.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01 Nr.143/26
Datë:29.05.2026

